



## **STATUTI I SHOQERISE**

### **“ELRODI-RAKS MUSIC” sh.p.k IMPORT-EXPORT**

**(Ortak i vetem)**

#### **FORMIMI**

##### **Neni 1**

Formohet Shoqeria tregtare me emertimin “ELRODI-RAKS MUSIC” me Pergjegjesi te kufizuar e themeluar nga ortaku i vetem Zoti Roland Llupo, i biri i Hillit dhe i Shpresës, lindur me 1959, banues ne Tirane, Rr.”Durresit”, pallati 220, Shk.2,Ap. 1/1

#### **SELIA E SHOQERISE**

##### **Neni 2**

Selia e Shoqerise eshte ne Tirane, Rr.”Durresit”,Pallati 220, Shk.2, Ap 1/1. Ajo mund te hape edhe vend qendrim te tjera te dyta, operative, filjale, perfaqesi dhe axhensi ne te gjithe territorin e vendit.

#### **KOHE ZGJATJA**

##### **Neni 3**

Kohe zgjatja e veprimtarise ekonomike te Shoqerise eshte mbi dhjete vjete dhe mund te shperbehet ne cdo kohe.

---

## **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

### **Neni 4**

Veprimtaria tregtare e shoqerise eshte sa vijon:

- Tregtim e regjistrim kasetash, vidio, audio-vidio me shumice e pakice Import-Export;

- Tregtimin e artikujve të ndryshëm industrialë, konfeksione, ushqimore, mobileri, materiale elektrike, ndërtimi, hidro-sanitare me shumicë e pakicë, import-export;

Si dhe cdo aktivitet tjetër që vecas ose së bashku me ato të përmendura më sipër do të ndikojnë në zhvillimin e rritjen e veprimtarisë së shoqerisë.

### **Neni 5**

Shoqeria mund të ndryshojë emrin, seline si dhe objektin e veprimtarisë së saj sipas vendimeve që do të marrë pronari i saj.

## **KAPITALI I SHOQERISE**

### **Neni 6**

Kapitali i shoqerisë është 100.000 leke i formuar në masën e plote nga ortakët i vetëm.

### **Neni 7**

Kapitali i shoqerisë mund të shtohet ose të pakesohet sipas vendimeve që do të marrë ortakët i vetëm.

## **DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI**

### **Neni 8**

Shoqeria, deklarohej e krijuar në zbatim të plote të normave që përmban ky statut dhe ato të legjislativës shqiptare në fuqi. Shoqeria, fiton zotesinë për të vepruar me regjistrimin e saj si person juridik në Gjykatën e Tiranës dhe ndërsa ushtron aktivitetin tregtar me regjistrimin në Zyren e Tatimeve.

---

## Neni 9

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen SHOQERIA TREGTARE "ELRODI-RAKS MUSIC" sh.p.k. IMPORT-EXPORT.

## Neni 10

Shoqeria tregtare, vepron ne regjimin e prones dhe merr persiper vete te drejtat e detyrimet. Ajo pergjigjet vete per detyrimet e saj kontraktore e jashte kontraktore brenda kapitalit te saj. Ortaku i vetem mbart rrezikun e veprimtarise se shoqerise ne nivelin e shumes se mjeteve te investuara ne shoqeri.

## Neni 11

Shoqeria, eshte prone e themeluesit te saj. Ajo merr vendime ne zbatim te ligjeve ne fuqi dhe sipas ketij statuti, te cilat jane te detyrueshme per te gjithë punonjesit ne kete shoqeri.

## Neni 12

Ortaku i vetem sipas nevojave qe paraqiten per zhvillimin e veprimtarise se shoqerise, emeron Administrator ROLAND LLUPON si dhe puneson punonjes te veprimtarive të ndryshme ekonomike te permendura ne nenin kater te ketij statuti.

## Neni 13

Ortaku i vetem i shoqerise dhe Administratori i ngarkuar prej tij jane te veshur me te gjitha fuqite per drejtimin e zakonshem dhe te jashtezakonshem te shoqerise pa asnje lloj kufizimi. Ai ka mundesi te kryeje te gjitha aktet qe konsideron te nevojshme per arritjen e qellimit te shoqerise. Ai ka te drejte midis te tjerash te bleje e te kembeje pasuri, te lidhet me shoqeri te tjera te vendit ose te huaja, te kryej cdo lloj veprimi prane te gjitha zyrave private apo shteterore qe kane te bejne me garancite, ipotekat. Te kryej prane instituteve bankare e financiare veprime depozitimi, kreditimi, pagesa dhe arketimi. Ne keto raste Administratori i ngarkuar ka per detyre te njoftoje dhe t'i jape llogari ortakut te vetem.

## Neni 14

Perfaqesimi i shoqerise i perket ortakut te vetem dhe Administratorit te ngarkuar. Ai ka te drejten e perfaqesimit te shoqerise ne organet gjyqesore dhe administrative, te caktojne e te pushojne avokat per cdo problem.

---

---

## BILANCI DHE TE ARDHURAT

### Neni 15

Veprimet ekonomike e financiare te shoqerise mbyllen ne 31 dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore, Administratori nxjerre bilancin kontabel te shoqerise me llogarinë FITIM HUMBJE, mbeshtetur ne ligje dhe rregulla te mbajtjes se kontabilitetit nga subjektet private percaktuar nga organet kopetente te sistemit fiskal. Bilanci kontabel miratohet nga ortaku i vetem, i cili vendos per krijimin e fondeve te ndryshme te nevojshme per zhvillimin e garancine e veprimtarise se shoqerisë, fondin e akumulimit, fondin rezerve etj.

### Neni 16

Te ardhurat neto pas vecimit te fondeve ligjore të permendura me siper dhe shlyerjen e detyrimeve fiskale nga fitimi i mbesin per perdorim ortakut te vetem.

## SHPERNDARJA E SHOQERISE

### Neni 17

Shperberja e Shoqerise mund te vije ne cdo kohe dhe per cfaredo shkak si humbja e kapitalit, pamundesi veprimtarie etj. Ne keto raste ortaku i vetem vendos mbi menyren e likujdimit dhe cakton nje ose me shume likujdatore. Keta bejne kujdes qe shoqeria te likujdoje me pare detyrimet qe ajo ju ka personave te trete fizik e juridik.

## DISPOZITAT E PERGJITHSHME

### Neni 18

Persa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve nga ortaku i vetem si dhe ligjeve perkatese shqiptare.

### Neni 19

Ky statut perpilohet ne disa kopje per t'ju shperndare organeve kopetente ndersa nje kopje mbetet si pjese perberse e dokumentacionit te themelimit te shoqerise.

ORTAKU I VETEM

*POLANID LLUPO*

*P. Llupo*

---

## AKTI I THEMELIMIT TE SHOQERISE

### "ELRODI - RAKS MUSIC" sh.p.k IMPORT-EXPORT

Sot, me datë 22.I.1997, unë i quajhuri Roland Llupo, i biri i Hillit dhe i Shpresës, lindur më 1959, banues në Tiranë, Rr."Durrësit", pallati 220, Shk.2, Ap.1/1, themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar si ortak i vetëm.

#### Neni 1

Shoqëria emërohet "ELRODI-RAKS MUSIC" sh.p.k. IMPORT EXPORT.

#### Neni 2

Selia e Shoqërisë është në Tiranë, në Rr. e "Durrësit", pallati 220, Shk.2, Ap 1/1

#### Neni 3

Shoqëria ka një aktivitet të saj tregtar mbi dhjetë vjet dhe mund të shpërëhet në çdo kohë.

#### Neni 4

Shoqëria ka për aktivitet të saj:

- Tregtim e regjistrim kasetash, vidio, audio-vidio,sh.p.k, import-export;
- Tregtimin e artikujve të ndryshëm industrial, konfeksione, ushqimorë, mobileri, materiale elektrike, ndërtimore, hidro-sanitare me shumicë e pakicë, import-export

Si dhe çdo aktivitet tjetër, që veças ose së bashku me ato të përmendura mësipër do të konsiderohen të përshtatshme dhe me leverdi për rritjen e zhvillimin e firmës.

#### Neni 5

Kapitali i shoqërisë është 100 000 lekë.

ORTAKU I VETEM  
ROLAND LLUPO

